

Urime Festat



Amfóra

albaqeramika

Lamtumirë 2017, mirësevjen 2018

Në fund të secilit vit bëhemi gati për të dhënë premtimet për vitin pasues.

Por para premtimeve hedhim shikimin prapa në vitin që po e lëmë për të analizuar atë që kemi bërë: arritjet dhe lëshimet. Duke qenë se tashmë jemi një kompani me mbi 100 punëtorë, me tri sallone të mëdha të shitjes dhe me shumë kontrata me ndërtues të ndryshëm, është e kuptueshme që kemi pasur një vit plot me aktivitete.

Sistemi Geberit dhe sanitaria nga oferta jonë është bërë pjesë e disa prej projekteve më interesante ndërtimore në vend siç është: Dukagjini WTC, Venus Hotel, Emerald Hotel dhe kompleksi i parë banesor në Junik, i quajtur Tilia.

Një gjë tjetër interesante e vitit 2017 është fakti që gjithnjë e më shumë bashkatdhetarë që jetojnë jashtë shtetit i kanë besuar produkteve tona, duke i bërë ato pjesë të shtëpive të tyre.

Për të qenë i pari në fushën ku vepron duhet të bashkëpunosh vetëm me të parët. Andaj me lehtësi ne kemi zgjedhur kompaninë Geberit kur kemi vendosur të ofrojmë produkte të instalimit të ujit dhe të kanalizimit.

Geberit është kompani zvicerane, ndër më të njohurat dhe më të besueshmet në botë, për instalime të ujit dhe të kanalizimit. Për ta çuar tutje ofertën tonë në këtë fushë, gjatë vitit 2017 kemi organizuar për punëtorët trajnime speciale në trajtimin dhe përdorimin e instalimeve dhe produkteve përcjellëse të Geberitit.

Në këtë mënyrë, përveç që kemi pasuruar ofertën, ne kemi ndihmuar edhe në zhvillimin dhe avancimin profesional të stafit tonë të përkushtuar. Me rritjen e vazhdueshme të ofertës sonë të bazuar në trendet më të fundit globale, kemi tërhequr rreth vetes bashkëpunimin me shumë arkitektë e dizajnerë të ndryshëm, të cilët në vazhdimësi kanë rritur interesimin për produktet tona në mënyrë që t'i përfshijnë në projektet e veta.

Kështu, pasi të kemi shikuar prapa veprimtarinë e kompanisë për vitin 2017, nuk është edhe aq e vështirë që të bëjmë premtimet për vitin pasues.

Me këtë rast ne premtojmë që do të jemi gjithmonë në hap me trendet më të reja perëndimore dhe të ju ofrojmë produktet dhe shërbimet që do të plotësojnë ëndërrat tuaja për dukjen e banjove, kuzhinave dhe shtëpive tuaja.



Dushi Ramon Soler



Ramon Soler është prodhues spanjoll me traditë 125-vjeçare, i njohur për cilësi në bateri, dusha dhe aksesore të banjos.

Produktet e kësaj kompanie janë prezente në 60 shtete të ndryshme dhe në 5 kontinente.

Koleksioni: Hidroterapia
Produkti: Dush nga tavani
Materiali: Krom

Rezistent dhe me ekstra shkëlqim
Mundëson shpërndarjen e përkryer të ujit
Kursen ujin për 30%
Antigëlqeror falë mbështjelljes me shtresa të silikonit



Azuma nga Imola



Arsyeja që prodhuesi Cooperativa Ceramica Imola ka qenë një pikë referimi në sektorin e qeramikës që nga viti 1874, është falë ndërthurjes ekskluzive mes traditës dhe inovacionit, gjë që ende sot e bën atë një markë të shkëlqyeshme ndërkombëtare.

Azuma, e cila është një ndër koleksionet e fundit të pllakave të përshtatshme për hapësira të mëdha të banimit, konsiderohet si fryma e fundit e dizajnit të arkitekturës, e cila veçanërisht po preferohet nga arkitektët tanë në këtë kategori të pllakave.



Karakteristikat e pllakës:
Porcelan i mbushur, mat,
120 - 120 cm, 60 - 120 cm,
60 - 60 cm, 30 - 60 cm
trashësi 10mm

Një Vit i Ri për fëmijët tanë



Të gjithë fëmijët kanë dëshirë ta vizitojnë vendin e punës së prindërve të vet.

Këtë përvojë e patën edhe fëmijët e stafit tonë në kohën më të mirë të vitit, në kohën e festave të fundvitit.

Fëmijët u befasuan me dhurata dhe shumë argëtim me babadimrin dhe me maskotat e tyre të preferuara.

Albaqeramika iu uron të gjithë stafit, bashkëpunëtorëve dhe klientëve një Vit të Ri të mbarë, të mbushur me shëndet dhe suksese.



Trajnimi i stafit të Albaqeramikës



Për të qenë në hap me teknikat dhe praktikat më të reja në botë në sektorin e shitjes dhe të qasjes ndaj klientëve, stafi i Albaqeramikës në tetor mbajti një trajnim që ofron po këto informata me ligjërues Denis Gafurrin. Trajnimi gjithashtu pati përplot aktivitete për zhvillimin e stafit të salloneve të Prishtinës, Pejës dhe Prizrenit. Denis Gafurri njihet si ekspert i mjeshtrisë së shitjes me përvojë shumë të gjatë në këtë fushë.



Trajnimi i mjeshtrëve me çertifikatë të Geberitit

Në bazë të vlerësimit dhe kërkesës së madhe të produkteve Geberit për instalimin e kanalizimit dhe ujësjellësit, ne mundësuar trajnimin dhe çertifikimin e shumë mjeshtrëve - bashkëpunëtorë tanë me çertifikatën e Geberitit e njohur ndërkombëtarisht.

Këto trajnime janë mbajtur nga stafi i Geberitit.



www.facebook.com/albaqeramika



twitter.com/ALBAQeramika



www.instagram.com/albaqeramika



+377 45 60 29 99 Prishtinë
+386 49 20 50 50 Pejë
+386 49 21 80 80 Prizren

Në Alba Qeramika mund të paguani edhe me POS të këtyre bankave :



ALBA Qeramika, km IV, magjistralja Prishtinë - Ferizaj

10000 Prishtinë

+386 49 20 60 60

office@albaqeramika.com

Implementuar nga

